



# TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL - KATALIZATOR PËR INTEGRIMIN EKONOMIK RAJONAL DHE PIKËMBËSHTETJE DREJT TREGUT TË VETËM TË BE-së

## SI DO TË PËRFITOJË KOMPANIA JUAJ NGA KY PROCES?







Vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor (BP) kanë bashkëpunuar në mënyrë intensive për të krijuar mundësi të reja për zhvillim, vende pune dhe rritje, duke maksimalizuar përfitimet nga rruga e tyre e përbashkët drejt anëtarësimit në BE.

Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal 2021-2024, që u mbështet nga udhëheqësit e gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor (BP6) – Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, në Samitin e Procesit të Berlinit mbajtur më datë 10 nëntor 2020 në Sofie, është vazhdim i përpjekjeve për nxitjen e bashkëpunimit ekonomik në BP6.

Me Tregun e Përbashkët Rajonal synohet rritja e interesimit për rajonin dhe aftësinë e tij konkurruese dhe sjellja e rajonit më pranë tregjeve të BE-së.

Në këtë proces nuk përfshihet krijimi i institucioneve të reja apo i subjekteve të reja politike, por, në fakt, ai nënkupton qasjen e bashkënduar të qeverive të BP6 ndaj krijimit të një zone bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, që sigurojnë lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit në mbarë rajonin, dhe qasjen e përbashkët në fushat e dixhitalizimit, investimeve, novacionit dhe industrisë.

Tregu i Përbashkët Rajonal është një hap në drejtim të anëtarësimit të plotë të vendeve të BP6 në BE. Kështu që hapat drejt krijimit të Tregut të Përbashkët Rajonal do të ndërmerren paralelisht me integrimin e përsheptuar dhe kalimin gradual në Tregun e Vetëm të BE-së.

”

E ardhmja e të gjithë rajonit është në BE. Ne ndajmë të njëjtën histori, ndajmë të njëjtin fat. Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës ...

Fjalim i Presidentes von der Leyen drejtuar Bashkimit Evropian, shtator 2020

“

#### CILI ESHTE PIKËSYNIMI I TREGUT TË PËRBASHKËT RAJONAL?

- ▶ Forcimi i aftësisë konkurruese të kompanive të BP-ësë në tregjet evropiane dhe globale
- ▶ Integrimi i tregut të 18 milion njerëzve
- ▶ Integrimi më i mirë i ekonomisë së BP-ësë në procesin evropian të rritjes së mëtejshme të vlerës së prodhimit, shërbimit etj.
- ▶ Mundësia për një rritje të mëtejshme të PBB-ësë prej 6.7%
- ▶ Sjellja e BP-ësë në qendër të vëmendjes së investitorëve të huaj që kërkojnë të shkurtojnë distancën me tregjet e BE-së dhe të zgjerojnë llojshmërinë e furnizuesve të tyre
- ▶ Mëkëmbja më e shpejtë e ekonomive të BP-ësë nga pandemia e COVID-19





”

Axhenda e Tregut të Përbashkët Rajonal përfaqëson vizionin e përparimit për qytetarët tanë teksa ata kërkojnë të gëzojnë të njëjtat liri si homologët e tyre në Bashkimin Evropian.

Deklaratë e udhëheqësve të Ballkanit Perëndimor për Tregun e Përbashkët Rajonal

“

## HISTORIKU I PROCESIT

Tregu i Përbashkët Rajonal mbështetet në arritjet e Planit Shumëvjeçar të Veprimit për një Zonë Ekonomike Rajonale në BP6, që u miratua në Samitin e Triestes mbajtur më datë 12 korrik 2017 në kuadër të Procesit të Berlinit. Ky dokument parashtrroi një axhendë të strukturuar për integrimin ekonomik rajonal, përfshirë nxitjen e integritimit të mëtejshëm të tregtisë, përfshirjen e një hapësire dinamike për investimet në rajon, lehtësimin e lëvizshmërisë në rajon dhe krijimin e një axhende dixhitale për integrimin.

Procesi i Berlinit është një nismë diplomatike, që ndërmori Kancelarja gjermane Angela Merkel në vitin 2014 dhe që synonte rritjen e bashkëpunimit rajonal në BP dhe përkrahjen e integritimit të vendeve të BP-së në Bashkimin Evropian. Procesi po zhvillohet me mbështetjen e Komisionit Evropian, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe Shteteve Anëtare të përfshira në Proces – Austrisë, Kroacisë, Francës, Gjermanisë, Italisë, Sllovenisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.

## ARRITJET E ZONËS EKONOMIKE RAJONALE 2017-2020

### TREGTIA



- ▶ Kuadri për liberalizimin e Tregtisë së Shërbimeve;
- ▶ Vendimi që përcakton procedurën e vlefshmërisë për njohjen e ndërsjellë të Programeve të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar;
- ▶ Vendimi për Lehtësimin e Tregtisë së Fruta- Perimeve;
- ▶ Mbledhja e plotë dhe rimbursimi i taksave doganore në fuqi.

### INVESTIMET



Oysh nga viti 2016 investimet e huaja të drejtpërdrejta janë rritur në masën 35%;

U finalizua dhe miratua Axhenda Rajonale për Reformën e Investimeve.

### LËVIZSHMËRIA



U miratua Deklarata për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në ekonomitë e BP-ësë.

### DIXHITALE



- ▶ Tarifat e shërbimit *roaming* 86-96% më të ulëta në BP;
- ▶ U organizua Samiti Dixhital i BP-ësë.

# SI MUND TË PËRFITOJË KOMPANIA JUAJ NGA TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL?

Njohja e plotë e dokumenteve që lidhen me eksportin, e kualifikimeve profesionale dhe elicencave në mbarë PB-ënë

Reduktimi deri në masën 70% l kohës së pritjes në pikat e kalimit falë pikave të shërbimit me një ndalesë, shërbimeve në dispozicion 24 orë në 7 ditë, Linjave të Gjebra dhe Korridoreve të Gjebër brenda BP-ësë dhe me BE-në

Reduktimi i kostove në pagesat rajonale; mundësimi i tregut rajonal të tregtisë në rrugë elektronike

Heqja e kërkesave për leje pune për transferimet ndërmjet kompanive dhe ofruesit e shërbimeve

Investime të huaja të drejtpërdrejta në proceset premtuese të qëndrueshme rajonale të rritjes së mëtejshme të vlerës të prodhimit, shërbimit etj.

Rajon pa tarifa për shërbimin *roaming* dhe reduktimi i tarifave për shërbimin *roaming* midis BP-ësë dhe BE-së

Program rajonal l mbështetjes së novacionit për biznesin inovativ *start-up* dhe në fazë të hershme, që ndërthur financimin e sektorit publik dhe privat

Njohja e ndërsjellë e nënshkrimeve elektronike dhe l formave të tjera të letërnjoftimeve elektronike dhe l shërbimeve të besimit bazuar në *acquis*-në përkatëse të BE-së

Mbullimi me 5G l qyteteve kryesore industriale të çdo ekonomie të BP6



Deri në muajin korrik 2021:

- ▶ Shtrirja e linjave të gjebra drejt BE-së
- ▶ Shërbimi *roaming* falas në të gjithë rajonin
- ▶ Marrëveshja për Udhëtimin me Letërnjoftim

## CILI ËSHTË PËRGJEGJËS PËR PROCESIN?

Zbatimi i Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal 2021-2024 mbetet në fushën e përgjegjësisë së institucioneve publike të çdo ekonomie të BP-ësë, sidomos të ministrive dhe institucioneve që drejtojnë përpjekjen e zbatimit në nivelin e ekonomisë. Sekretariatet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe CEFTA-s do të jenë organizatat kryesore rajonale, të cilave do t'u ngarkohet mundësimi i zbatimit të këtij Plan Veprimi. Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal është ngarkuar me bashkërendimin dhe monitorimin e përgjithshëm të Planit të Veprimit, ndërsa Sekretariati i CEFTA-s është ngarkuar me zbatimin e veprimeve që lidhen me tregtinë.

## CILI DO TA BËJË BASHKËRENDIMIN E PROCESIT?



Këshilli për Bashkëpunim Rajonal do të mbështesë kryerjen e veprimeve me anë të të cilave synohet rritja e interesimit të investitorëve të huaj për rajonin, integrimi i BP-ësë në zonën dixhitale pan-evropiane, përmirësimi i bazës industriale dhe infrastrukturës së novacionit dhe shkuarja drejt lëvizjes së lirë të njerëzve dhe kapitalit.



Sekretariati i CEFTA-s do të mbështesë kryerjen e veprimeve me anë të të cilave synohet zbatimi i CEFTA 2006 dhe shtrirja e angazhimeve dhe interesave drejt BE-së dhe partnerëve të tjerë tregtarë.



Forumi i Investimeve të Dhomave të BP6 e ka mbështetur aktivisht procesin duke ofruar kontributin e bizneseve gjatë fazës së planifikimit, duke monitoruar rezultatet dhe duke përcjellë opinionet vlerësuese të komunitetit të biznesit, ndërsa ka nënvizuar prioritetet nga këndvështrimi i tyre gjatë zbatimit.

BE-ja do të vazhdojë ta mbështesë procesin, përfshirë zbatimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve për BP-ënë, që synon nxitjen e mëkëmbjes ekonomike të rajonit në periudhë afatgjatë, mbështetjen e tranzicionit të gjelbër dhe dixhital, nxitjen e integritimit rajonal dhe bërjen pjesë në Bashkimin Evropian.



Plani Ekonomik dhe i Investimeve parashikon një paketë investimesh të rëndësishme që mobilizon një financim deri në 9 miliard euro për rajonin. Plani do të mbështesë ndërlidhjen e qëndrueshme, kapitalin njerëzor, aftësinë konkurruese, rritjen gjithëpërfshirëse dhe tranzicionin e dyfishtë të gjelbër dhe dixhital.

Përveç financimit të konsiderueshëm me anë grantesh të BE-së për rajonin, BE-ja mund të ofrojë garanci me qëllim reduktimin e kostos së financimit për investimet publike dhe private dhe reduktimin e riskut për investitorët. Parashikohet se, në dhjetëvjeçarin e ardhshëm, mbështetja përmes instrumentit të ri të Garancisë për Ballkanin Perëndimor, në kuadër të Garancisë për Veprim të Jashtëm të BE-së dhe të Fondit Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus, potencialisht, do të mobilizojë investime deri në 20 miliard euro.



## SI DO TË PËRFSHIHET NË KËTË PROCES SEKTORI PRIVAT?

Forumi i Investimeve të Dhomave të Ballkanit Perëndimor 6 (WB6 CIF) është një nismë e përbashkët e dhomave të tregtisë dhe industrisë të Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Serbisë, që u themelua në vitin 2017 gjatë Samitit të Triestës me qëllim sigurimin e një platforme të përbashkët për komunitetin e biznesit në rajon, lehtësimin e kontakteve ndërmjet bizneseve dhe promovimin e rajonit si destinacion investimesh. WB6 CIF, që përfaqëson mbi 350.000 kompani, është përfshirë aktivisht në hartimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit duke ofruar kontributin, prioritetet dhe opinionin vlerësues të komunitetit të biznesit.

Këshilli i Biznesit të WB6 CIF, si organ këshillimor i Bordit Drejtues të WB6 CIF i përbërë nga pronarët ose drejtuesit e nivelit C të 16 kompanive kryesore që operojnë në BP, mbi bazën e kriterëve të matshme, do të monitorojë ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit dhe do t'i informojë rregullisht qeveritë e BP-ësë dhe të gjitha palët e interesuara në proces mbi gjendjen në terren, duke bërë, bazuar në përvojën e punës së përditshme dhe të analizave të hollësishe, propozime konkrete dhe sugjerime për masa me qëllim eliminimin e pengesave, reduktimin e kostove dhe lehtësimin e kushteve për të bërë biznes në rajon dhe drejt BE-së. Këshilli do të sjellë një qasje më fleksibël dhe joburokratike ndaj zgjidhjes së problemeve me të cilat përballlet çdo ditë ekonomia, dhe një stimul të ri në dialogun midis komunitetit të biznesit të rajonit dhe qeverive të BP-ësë dhe institucioneve të Brukselit.

### MERRNI PJESË NË PROCES

- ▶ Kontaktoni WB6 CIF dhe anëtarët e dhomës kombëtare të tregtisë të WB6 CIF lidhur me pengesat e hasura në bashkëpunimin rajonal;
- ▶ Paraqitini propozimet tuaja për eliminimin e pengesave në bashkëpunimin rajonal;
- ▶ Ndiqini veprimtaritë tona për monitorimin dhe dokumentimin e ecurisë së prekshme siç perceptohet nga komuniteti i biznesit të rajonit.

### Veprimtaritë e WB6 CIF në këtë proces:

- ▶ Mbështetje individuale dhe të përshtatur për të kërkuar mundësi për të bërë biznes dhe mundësi financimi përmes kufijve për kompanitë e rajonit
- ▶ Një sërë mjeteve për zhvillimin e programeve kompjuterike në rrugë elektronike me të dhëna për hyrjen në tregun e rajonit
- ▶ Bankë të dhënash me informacione për tregjet në mbështetje të ndërkombëtarizimit të SME-ve
- ▶ Veprimtari biznes me biznes dhe konferenca për investime
- ▶ Përcaktim i furnizuesve dhe bashkërendim i programit për zhvillimin e furnizuesve rajonalë, me fokus të veçantë në industrinë e prodhimit të automobilitave dhe atë agro-ushqimore dhe ekonominë ciklike/e gjelbër.



## I ZONA TREGTARE RAJONALE

### PLANI I VEPRIMIT PËR TREGUN E PËRBASHKËT RAJONAL (2021-2024): FUSHAT E FOKUSIT DHE VEPRIMET RAJONALE

- ▶ Ruajtja e Linjave të Gjelbra dhe shtrirja e tyre drejt pikave të kalimit kufitar (PKK-ëve) me BE-në;
- ▶ Përfshirja në disa PKK-ë/pika të kalimit të përbashkët (PKP-ë) e pikave të shërbimit me një ndalesë dhe formaliteteve të thjeshtuara – reduktimi deri në masën 70 % i kohës së pritjes në kufi;
- ▶ Vënia në dispozicion e shërbimeve 24orë në 7 ditë në disa PKK-ë/PKP-ë;
- ▶ Harmonizimi i orarit të punës të agjencive të përfshira në zhdoganimin e mallrave;
- ▶ Përmirësimi i sistemit me korsi për një menaxhim më të mirë gjatë orëve kulmore të trafikut;
- ▶ Përsheptimi i qarkullimit të **disa** produkteve thelbësore (p.sh.: produktet e freskëta bujqësore);
- ▶ Eliminimi i pengesave jotarifore;
- ▶ Vendosja e një mekanizmi efikas dhe efektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- ▶ Përmirësimi i bankave të të dhënave për masat tregtare të Palëve të CEFTA-s dhe ushtrimi i kontrollit ndaj ndihmës shtetërore dhe konkurrencës;
- ▶ Vendosja e bashkëpunimit rajonal sa i takon çështjeve mjedisore lidhur me tregtinë (p.sh.: matja e CO<sup>2</sup>), mbrojtjes së konsumatorit, mbikëqyrjes së tregut dhe prokurimit publik;
- ▶ Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit mbi tarifatat dhe taksat për bizneset, kohën mesatare të kalimit të mallrave dhe zhdoganimit, mundësitë për SME-të për të bërë tregti.

#### LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

Programet për Njohjen e Ndërsjellë (PNJN) për produktet industriale dhe bujqësore

Strategji dhe veprime për menaxhimin e riskut doganor mbështetur nga zgjidhjet e reja të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)

Menaxhimi i riskut dhe shkëmbimi sistematik i të dhënave për të gjithë procedurën e zhdoganimit

Shkëmbimi i të dhënave në rrugë elektronike

#### LËVIZJA E LIRË E SHËRBIMEVE

Turizmi, financat, shpërndarja e kolive dhe tregtia në rrugë elektronike

Kualifikimet profesionale të njohura mbi bazën e sistemit të përgjithshëm të njohjes të BE-së

Paketa e liberalizimit të tregtisë së shërbimeve

#### LËVIZJA E LIRË E NJERËZVE

Lëvizja e lirë në rajonin e BP-ësë me letërnjoftim

Lëvizja e lirë e Qytetarëve të Palëve të Treta pa viza

Lejet e punës të panevojshme për transferimet ndërmjet kompanive dhe për ofruesit e shërbimeve

#### LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

Pagesa të menjëhershme brenda vendit të lidhura në nivel rajoni

Pagesa me kosto efektive brendapërbrenda rajonit dhe me BE-në – njëhap drejt Zonës së Pagesave Vetëm me Euro (SEPA)

Bashkëpunimi rajonal në fushën e financimit bankar dhe jobankar, financimit bujqësor, financimit të faturave, financimit të gjelbër



## II Zona e investimeve rajonale

- ▶ Krijimi i bashkëpunimit midis agjencive kombëtare për promovimin e investimeve dhe të një qasjeje të bashkënduar të promovimit në nivel rajoni për thithjen e investimeve në sektorët e synuar me përparësi/proceset e rritjes së mëtejshme të vlerës së prodhimit, shërbimit etj.;
- ▶ Mundësimi i zgjidhjes së shpejtë të mosmarrëveshjeve për çështje të investimeve të huaja të drejtpërdrejta;
- ▶ Zbatimi i reformave për politikatat e investimit në rajon dhe garantimi i transparencës së stimujve për investime.



## III Zona dixhitale rajonale

- ▶ Ofrimi i aksesit fiks në internet me brez të gjerë (*broadband*) për të paktën 95% të familjeve të çdo ekonomie;
- ▶ Hartimi i një strategjie rajonale 5G: mbulimi i qyteteve kryesore industriale dhe i të paktën një korridorit kryesor të rajonit, përkatësisht, deri në fund të vitit 2023 dhe 2025;
- ▶ Heqja e tarifave për shërbimin *roaming* brendapërbrenda BP-ësë dhe ulja e tarifave të shërbimit *roaming* midis BP-ësë dhe BE-së;
- ▶ Identifikimi i nevojave të grupeve të synuara (p.sh. bizneset inovative (*start-ups*)/të rinjtë, të rriturit) për aftësitë dixhitale të BP-ësë dhe ofrimi i trajnimit të duhur;
- ▶ Promovimi i ekonomisë dixhitale: ndërfornimi rajonal i shërbimeve të taksave të kalimit, rrjeti i qyteteve inteligjente, promovimi i inteligjencës artificiale, pjesëmarrja e BP-ësë në projekte të proceseve kompjuterike me performancë të lartë (HPC), bashkëpunimi rajonal për zhvillimin e qeverisjes në rrugë elektronike.



## IV Zona rajonale industriale dhe e novacionit

- ▶ Integrimi i rajonit në Hapësirën Evropiane të Kërkimeve (Platforma për Novacion dhe Kërkime e BP-ësë);
- ▶ Mbështetja e krijimit të akseleratorëve dhe inkubatorëve (Rrjeti i Qendrave të Novacionit Dixhital të BP-ësë);
- ▶ Inkurajimi i transferimit të njohurive nga ekspertët e diasporës;
- ▶ Mbështetja e bizneseve inovative (*start-ups*)/ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të përqendruara në ekonominë e gjelbër, sistemet e qëndrueshme të ushqimeve, prodhimin e energjisë së pastër dhe përdorimin e saj në prodhimin industrial;
- ▶ Vënia e furnizuesve vendas në kontakt me kompanitë shumëkombëshe në mbarë BP-ënë;
- ▶ Krijimi i një banke të dhënash për inteligjencën për tregjet dhe për të dhëna të rëndësishme me qëllim ndërkombëtarizimin e SME-ve (përmirësimi i platformës ekzistuese të SME-ve të BP-ësë [www.wb6cif.eu](http://www.wb6cif.eu));
- ▶ Zhvillimi i avantazheve konkurruese të industrisë rajonale të automobilitave;
- ▶ Zhvillimi i një kuadri për zbatimin e projekteve që synojnë ekonominë e gjelbër dhe ciklike;
- ▶ Përhapja e strategjisë rajonale "Nga ferma në tavolinë" dhe promovimi i prodhimit të qëndrueshëm dhe konsumit të ushqimeve;
- ▶ Rritja e sensibilizimit të rajonit lidhur me standardet e cilësisë së ushqimeve të BE-së;
- ▶ Përmirësimi i mbështetjes financiare për industrinë krijuese;
- ▶ Rritja e aftësisë konkurruese e industrisë së përpunimit të metaleve duke modernizuar programet mësimore dhe duke stimuluar efikasitetin e energjisë;
- ▶ Promovimi i turizmit të qëndrueshëm rajonal.

Nëse doni të merrni më shumë informacion apo të merrni pjesë në këtë proces, na kontaktoni:



Western Balkan 6 Chamber Investment Forum

P: +39 040 670 1325

E: [office@wb6cif.eu](mailto:office@wb6cif.eu)

W: [www.wb6cif.eu](http://www.wb6cif.eu); [www.investinsee.com](http://www.investinsee.com)

14, Piazza della Borsa, Trieste, Italy





### Economic Chamber of North Macedonia

Tatjana Shterjova Dushkovska  
P: +389 2 3244 065  
E: tatjana@mchamber.mk  
W: www.mchamber.mk



### Chamber of Commerce and Industry of Serbia

Marko Mandic  
P: +381 11 41 49 479  
E: marko.mandic@pks.rs  
W: www.pks.rs



### Foreign Trade Chamber of Bosnia and Herzegovina

Danijela Kovac  
P: +387 33 566 267  
E: danijela.kovac@komorabih.ba  
W: www.komorabih.ba



### Chamber of Economy of Montenegro

Balsa CULafic  
P: +382 20 230 446  
E: bculafic@pkcg.org  
W: www.privrednakomora.me



### Kosova Chamber of Commerce

Parim Bajrami  
P: +383 (0) 44 900 993  
E: parim.bajrami@oek-kcc.org  
W: www.oek-kcc.org



### Union of Chambers of Commerce and Industry of Albania

Evis Dino  
P: +355 (0) 44500221  
E: info@uccial.al  
W: www.uccial.al



